



Pranuar / Dorezuar Prilpjen / Prilpjen Received / Delivery	07. 07 2022	viti god year	2
Organ / Njësia Organ / Jediniца Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shërbimi Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHK	3987/2022		1/5



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.474/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Hxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtarë me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.474/2022 të datës 24.05.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë kundër Vendimit me numër 0562 të datës 17.05.2022 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike "Transfer", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, të mbajtur më datë 07.07.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** si bazuar ankesa A.nr.474/2022 e datës 24.05.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. **SHFUQIZOHET** Vendimi Nr. 0562 i datës 17.05.2022 i Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës.
- III. **OBLIGOHET** Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues i Kosovës, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit, duke e kthyer ankuesin në vendin e punës Udhëheqës i Divizionit Ligjor, sipas Akt Emërimit të datës 22.09.2012.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi [redacted] i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, me datë 24.05.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 2990/2022 të regjistruar me A.nr.474/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr. 0562 të datës 17.05.2022 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës për transferim të përkohshëm nga pozita "Udhëheqës i Divizionit Ligjor" në Shërbimin Korrektues të Kosovës në pozitën "Zëvendësdrejtor në Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë".

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datë 31.05.2022, ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë te organi i punësimit, ndërsa me datë 16.06.2022 Këshilli ka pranuar nga Shërbimi Korrektues i Kosovës përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat tjera ndërlidhur me lëndën.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova: Ankesën me Nr.prot:2990/2022 të datës 24.05.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendim me Nr. 0562 të datës 17.05.2022 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Akt Emërimi i N.H. i datës 21.09.2012; Vendim për transferim me numër protokoli 0458 i datës 02.06.2020 i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Plotësim i ankesës me numër protokoli 3141 i datës 30.05.2022; Vendim për transferim me numër protokoli 018 i datës 09.01.2019 i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës; e-mail zyrtar i datës 02.06.2020; Vendim për transferim me numër protokoli 2056 i datës 15.08.2019 i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 31.05.2022; e-mail zyrtar me nr. protokoli 3546 i datës 16.06.2022; Përgjigje në ankesë me nr. protokoli 658 e datës 16.06.2022; e-mail nga M.B. për R.H. i datës 06.04.2022; e-mail nga M.B. për R.H. i datës 21.02.2022; e-mail nga N.TH. për R.H. i datës 02.06.2020; e-mail nga N.H. për N.TH. i datës 02.06.2020; Përshkrimi i Detyrave të Punës i datës 01.08.2014; e-mail nga C.Z. për R.H. i datës 21.06.2022; e-mail nga R.H. për C.Z. i datës 21.06.2022; e-mail nga I.D. për R.H. i datës 21.06.2022; e-mail nga S.G. për I.D. i datës 17.05.2022; e-mail nga N.H. për S.G. i datës 17.05.2022; e-mail nga Drejtoria SHKK për N.H. i datës 17.05.2022;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se pretendimet ankimore, kundër vendimit mbi transferimin e përkohshëm të ankuesit **është e bazuar, sepse:**

Në bazë të provave të lëndës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se ankuesi sipas Akt Emërimin të datës 22.09.2012 është i punësuar në pozitën "Udhëheqës i Divizionit Ligjor" në Shërbimin Korrektues të Kosovës.

Fillimisht ankuesi në bazë të Vendimit me Nr. 0458 të datës 02.06.2020 është transferuar në mënyrë të përkohshme nga pozita "Udhëheqës i Divizionit Ligjor" në zyrat e Shërbimit Korrektues të Kosovës që janë në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike për periudhën nga data 05.06.2022 deri më datë 05.06.2021, ku transferimi është bërë mbi bazën e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 06/2010 për Transferimin e Nëpunësve Civilë.

Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës më datë 17.05.2022 ka nxjerr Vendim me Nr. 0562 për transferim të përkohshëm nga pozita "Udhëheqës i Divizionit Ligjor" në pozitën "Zëvendësdrejtor në Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë". Transferimi është bërë në bazë të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr. 0562 të datës 17.05.2022 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës pretendon që ky transferim është në kundërshtim me dispozitën e nenit 52 për transferim të përkohshëm të Ligjit Nr.06/L114 për Zyrtarët Publikë, sepse ky transferim është bërë pa kaluar një vit nga transferimi i vitit 2020.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke u bazuar në provat e lëndës, konstaton se në kohën kur ankuesi është transferuar sipas Vendimit me Nr.0458 të datës 02.06.2020 të aplikueshme kanë qenë dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 06/2010 për Transferimin e Nëpunësve Civilë të cilat kanë rregulluar çështjen e transferimit të nëpunësve civil, ndërsa vetëm një muaj pasi që është bërë ky transferim, ka filluar të zbatohet Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë sipas Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetues të Republikës së Kosovës të datës 09.07.2020.

Duke i'u referuar dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës konkretisht nenit 16 paragrafi 1 i cili ka përcaktuar që: *"Zyrtarët e lartë drejtues dhe zyrtarët drejtues në shërbimin civil, mund të caktohen në pozita të ndryshme me gradë ekuivalente për një periudhë të caktuar kohore, por jo më shumë se gjashtë (6) muaj"*, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se meqenëse ankuesi mban pozitë drejtuese nuk ka mund të transferohet për një periudhë më të gjatë se gjashtë muaj, ndërsa sipas Vendimit të datës 02.06.2020 ky transferim ka ndodh për një kohëzgjatje prej një viti.

Dispozitat transitorie të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht nenit 83 paragrafi 9, ku përcaktohet se: *"Institucionet publike do të sigurojnë përfundimin e konkursit të shpallur dhe procedurave të tjera të nisura para hyrjes në fuqi të këtij ligji. Procedurat që janë në vazhdim e sipër, kur ky ligj hyn në fuqi, do të vazhdojnë sipas ligjit të ri. Për procedurat disiplinore në proces, nëse kjo është më e favorshme për nëpunësin civil në fjalë, me kërkesën e tij, zbatohen procedurat e ligjit të ri. E njëjta procedurë do të aplikohet për procedurat e ankesave dhe kontesteve."*, sipas Kolegjit për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, kjo dispozitë i referohet të gjitha procedurave që kanë të bëjnë me shërbimin civil, kështu që përveç proceduarve të rekrutimit dhe procedurave disiplinore dhe të ankesave, proceduarat e tjera që janë në vazhdim e sipër, kur ky ligj hyn në fuqi, do të vazhdojnë sipas ligjit të ri, mbi këtë bazë kjo vlen edhe për procedurat e transferimit.

Bazuar në këto dispozitat ligjore, si dhe referuar faktit që në kohën kur ka hyr në fuqi Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ankuesi ka qenë i transferuar për një periudhë gati një vjeçare, atëherë sipas vlerësimit të Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, një transferim tjetër pa kaluar një afat dy vjeçar nuk do të mund të ndodh dhe është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, konkretisht nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, rrjedhimisht

Vendimi me numër protokolli 0562 të datës 17.05.2022 i Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës është në kundërshtim me nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, dhe me nenin 4 paragrafin 1 të Rregullores (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil, sepse me rastin e transferimit të ankuesit sipas vendimit të konstatuar me ankesë nuk janë shqyrtuar në mënyrë të drejtë faktet dhe normat juridike mbi bazë e të cilave një akt administrativ do të ishte i ligjshëm, andaj meqë nuk janë shqyrtuar në mënyrë të drejtë rrethanat e rastit të ankuesit, sipas fuqisë ligjore ky akt administrativ bëhet i paligjshëm në kuptim të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Po ashtu Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, vëren se vendimi i goditur me ankesë është lëshuar nga Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, gjegjësisht ky vendim është nxjerrë nga organi jo kompetent sepse bazuar në nenin 5 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë është përcaktuar se: *Transferimi i përkohshëm në interes të institucioni, miratohet nga njësia përgjegjëse, e cila njofton me shkrim nëpunësin civil që do të transferohet. Për marrjen e këtij vendimi njësia përgjegjëse mbështetet në analizën e plotësimin nga ana e nëpunësit të kritereve të pozitës të punës ku ai kërkohet të transferohet. Në këtë kontekst e në mbështetje të nenit 14 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë njësi përgjegjëse konsiderohet Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore.*

Andaj, bazuar si me lartë, e në vështrim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, 1.3 dhe 1.5 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, një akt administrativ i nxjerrë nga organi që nuk ka kompetencë, me shkelje të dispozitave procedurale dhe materiale është akt administrativ i paligjshëm, kështu që Këshilli me qëllim të vendosjes së ligjshmërisë, e duke iu bazuar në autorizimet e përcaktuar me nenin 55 paragrafët 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ka shfuqizuar Vendimin me numër protokolli 0562 të datës 17.05.2022 i Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, duke obliguar këtë të fundit që brenda afatit të përcaktuar si në pikën III të dispozitivit ta kthejë ankuesin në pozitën "Udhëheqës i Divizionit Ligjor" sipas Akt Emërimit të datës 22.09.2012 me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen nga marrëdhënia e tij e punës.


Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
LËNDA ME NUMËR A.NR.474/2022

Çlirim Zeka


Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Shërbimin Korrektues të Kosovës ;
- Arkivit të KPMSHCK-së;

